



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal Kaçanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr. 104/02-14973/24
Kaçanik, 28.06.2024

Në bazë të Vendimit të KQZ-së, Nr. 01/996/2024 të datës 18.06.2024, protokollit i komunës 01Nr. 60/01-14334/2024 i datës 19.06.2024, me të cilin është caktuar Zëvendësimi i anëtarit të dorëhequr, Fitore Vishi, me kandidatin e radhës nga po i njëjti subjekt politik Partia Demokratike e Kosovës-PDK, Lirije Dema, Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë 28.06.2024, i konstatoj:

**Ndryshim Plotësimin e Përbërjes së Kuvendit të Komunës Kaçanik
të Legjislaturës së shtatë (7) të zgjedhur me 17 Tetor 2021**

- LIRIJE DEMA** – nga subjekti politik “Partia Demokratike e Kosovës- PDK” sipas Vendimit të KQZ Nr. 01/966/2024 të datës 18.06.2024 (bashkangjitur kësaj shkrese) është emëruar, Anëtar (Këshilltar) i Kuvendit të Komunës Kaçanik, në vend të Anëtarit të dorëhequr të Kuvendit të Komunës Kaçanik, Fitore Vishi.
- Betimin për Anëtar të Kuvendit të Komunës, Lirije Dema e ka dhënë në mbledhjen e Rregullt të Kuvendit të Komunës më datë: 28.06.2024. Nga kjo datë realizon të gjitha të drejtat dhe detyrat si anëtarët tjerë të Kuvendit të Komunës, përfshirë edhe çështjen e kompensimit.
- Anëtari i Kuvendit të Komunës Kaçanik nga pika 1 e kësaj shkrese, më rastin e dhënies së Betimit Solemn dhe nënshkrimit të Deklaratës Solemne, para Kuvendit të Komunës, u zotua se merr përsipër detyrat e anëtarit të Kuvendit Komunal të përcaktuara si në dispozitat e nenit 35.4 të LVL.
- Mandati i anëtarit të Kuvendit të Komunës është i lidhur më mandatin e Kuvendit të Komunës, fillon nga data e emërimit në këtë post politik, respektivisht pas dhënies së Betimit Solemn dhe nënshkrimit të Deklaratës Solemne për Anëtar të Kuvendit të Komunës Kaçanik, ndërsa përfundon sipas dispozitave të nenit 37.2 të LVL.
- Obligohen organet relevante të komunës t’i marrin veprimet e nevojshme për futjen në Listën e Pagave anëtarin e Kuvendit të Komunës, Lirije Dema dhe heqjen nga Lista e Pagave, anëtarin e dorëhequr, Fitore Vishi.

Me këtë shkresë njoftohen: Kryetari i Komunës; Zyra e Personelit; Drejtoria e Buxhetit dhe Financave; Arkivi.



Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

I	Data	19.06.2024	Vendi	KAÇANIK
Nj. org.	Numri	Shtojcë		
	01-060/01-14334/24			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, nenin 41 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese, me datë, 18.06.2024, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj.Lirije Dema**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Kaçanik, nga subjekti politik "Partia Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal znj.Fitore Vishi.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj.Lirije Dema dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 13.06.2024, Nr.09/1-952/2024, për zëvendësimin e anëtares të kuvendit komunal znj.Fitore Vishi, e cila ka dhënë dorëheqje, për arsye të punësimit në shërbimin civil.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja e radhës në listën e rirenditur është znj.Lirije Dema.

Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 %, të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë 18.06.2024

Kryesues
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

Kreshnik Radoniqi